



Procesverbal 4/2024

I mbajtur në mbledhjen e IV-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Emini - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën **29.04.2024** në ora **10³⁰**, takimi në Qendër të Fshatit Dubravë.

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për Komunitete;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;
4. Vizitë në Qendrën e Fshatit Dubravë;
5. Njoftim nga ZKKK –ja Zyrja në Fshatin Dubravë, lidhur me kërkesat, brengat e qytetarëve në Fshatin Dubravë dhe
6. Të ndryshme.

1. **Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini** – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje – Prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;
2. U Miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;
3. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Vizita Qendra Dubravë, Osman Emini prezantoi anëtarin Minavere Fejzullahun për punën në Qendër;

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Kanë marr pjesë rreth 200 fëmijë në pragramin e shkollës, janë të licensuar nga ministria.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Në këtë Qendër janë kompetent:

1. Shëndetësia;
2. Mirëqenia Sociale;
3. Edukimi dhe
4. Kultura.

Amir Rexhepi – Në mësimin plotësues, kush merr pjesë?

Minavere Fejzullahu – Marrin Pjesë nga klasa I- IX, por marrin pjesë edhe disa studentë ose edukator dhe kemi marr si shembull që duhet të mësojnë. Tek ne shprehim të gjitha problemet që kanë, madje edhe problemet e shtëpisë janë në gjendje të tregojnë

- Kemi licencë për Plan program.

Amir Rexhepi – A ka pas efekt mësimi plotësues?

Minavere Fejzullahu – Ka pasë shumë efekt.

- Kemi pas mungesë 5 javë, shkak i kontratës me KARITAS - Komunë dhe është vërejt mungesa e fëmijëve në shkolla, ne ju japim kurajo dhe janë të kënaqur, kanë sjellje më të mirë, nuk mungojnë.

Flora Abdullahu - Fëmijët a vijnë në forma vullnetare apo janë të obligueshëm.

Minavere Fejzullahu – Vijnë në forma vullnetare, vetëdisohen për shkolla të mesme, përgatitin dokumentet dhe i shtyejnë përpara.

Amir Rexhepi – Në shkolla të mesme janë shumë pak të interesuar.

Minavere Fejzullahu – Shkuarja në shkolla të mesme nuk është obligative, të kemi pas aktivitete, duhet të bëhet ndryshime te filloret nga klasa e VI-të dhe të bëhen përgatitje për shkollë të mesme. Një nxënës thotë pse të mësojë kur shkollën e kryejmë dhe nuk punësohemi, shkojnë të aplikojnë për punë e pyesin se nga cili komunitet je.

- Të ndryshohen politikat për nxitjen e fëmijëve të mos e braktisin mësimin.

Minavere Fejzullahu – Të inkuadrohemi dhe të bëjmë ndryshimin e politikave që fillimi i klasës të filloi nga klasa e VI-të dhe të jetë obligative.

Xhamajl Jashari – Ka praktika që profesorët i bijnë nxënësit në praktikë dhe nuk merren me to, nuk i shpjegojnë provat si duhet.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emini – Kam dokument të përgatitur, Planin e veprimtimit për gjithëpërfshirjen e komuniteteve rom, ashkali që ekzistojnë.

- Është ende e pa aprovuar nga Kuvendi i komunës.
- Është një strategji gjithpërfshirës.
- Komunitetet rom, ashkanli, egjiptijan do të pësojnë humbje nga kjo strategji.

Minavere Fejzullahu – Një mësimdhënës nuk e ka dëshirën të diskutojë me fëmijën pse nuk është në disponim, kurse në qendër jemi më të afërt.

- Ne si shoqëri, Kuvendi i komunës të bëjë një trysni të manifestohen mësimdhënësit të shikohet se a kanë metodologji për punën që e bëjnë.

Xhemajl Jashari – Mendoj se mungon dëshira e mësimdhënësve ndaj nxënësve dhe se gjeneratat e reja nuk e bëjnë punën me dashuri.

Hajriz Haziri – Të bëhet një zgjidhje, të bëhet monitorimi.

Flora Abdullahu – Të bëhet një takim i përbashkët, të nxirret një Raport, të dorëzohet në drejtori.

- Në cilën klasë ka mungesa dhe cilët janë arsyet.

Munges aka në shumë klasa të larta, arsyet janë ; puna, mbajtja e familjes si dhe martesë e hershme.

- Si janë Raportet me zyrtarin e ZKKK-së, Raportet janë mirë, mirëpo nuk bëjnë shumë.

Minavere Fejzullahu – Është një problematikë që nxënësi herë e ndalon shkollën, nuk ndrron vendbanimin nuk pyet e as nuk i kthehet dhe llogaritet si braktisje të shkollës.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emiri – Këtë vit a ka braktisje të shkollës.


Minavere Fejzullahu – Një ose dy janë braktisës, ka edhe që dalin në klasa më të larta dhe nuk dinë shkrim e lexim.

Komiteti për Komunitete dhe Qendra të kenë media në shkollë.

Kryesues i Komitetit për komunitet Osman Emiri – Sa për afërsisht qendra me ba furnizim nga lista esenciale.

Minavere Fejzullahu – Furnizimi bëhet në forma të projekteve që bënë KARITAS - Kosova.

Procesmbajtësi


Xhemajl Jashari

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete


Osman Emiri

